## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: *Korporat Energjetike e Kosoves KEK sh.a.*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-1746-1-2-1** *dhe e mbrendshem*

*KEKO-23-070-121*

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

# ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

*(ND shpk)*

*(Vendi) Prishtine 10000* *(Kodi postar)*

*__044124661_____*
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

*Avni Musliu*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*(Adresa elektronike)*
*ndshpk@yahoo.com*

*__15.01.24_____*
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*
**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*
*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____
*(Emri i avokatit)*

_____
*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

*07.03.23 Njoftimi per kontrate,*
*21.12..23 Leter standarde per tenderuesin e papergjegjeshum*
*21.12.23 Njoftim mbi vendimin e AK*
*26.12.23 Kerkesa per rishqyrtim*
*04.01.24 Pergjejea ne kerkesen per rishqyrtim nga ana e AK*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**LPP:Neni 1;Neni 4.Pika 1.26:pika 3 dhe pika 6;neni 117 pika 1;neni 98 pika 1 dhe 3; neni 109 pika 1;neni 104 pika 2 dhe 3;neni 59 pika 2 dhe 4; neni 28; neni 72,**
**DT neni 3. 7**
**Rregullorja nr.01/2022 per PP neni 40;Neni 59 pika 1;neni 67 pika 7**
**Rregullorja 01-2020 e punes se OSHPP:Neni 2 pika 1.2**

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**E kundershtojm vendimin e AK per anulim te tenderit dhe eliminimin si i papergjegjeshum !**
**Arsyetimet tona jane** :
Neni 4 pika 1.26 e LPP: citoje: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar Perfundim citati.
**Deshmi se jam pale e interesuar qe deshmon interes material me deshmi materiale eshte polisa e sigurimit valide per oferten tone valide,paneli i OSHP dhe AK po i jep dykuptimesi nenit ne fjale.**
Neni 2 pika 1.2 te Rregulloreja nr 001/2020 e punes se OSHP citoje: Pale-eshte qdo person i cili ne lendet e trajtuara nga OSHP,paraqitet ne cilesi te autoriteti kontraktues,ofertuesit,personit te interesuar,perfaqesuesit ligjor apo i autorizuar i tyre .Perfundim citati.
**Ne jemi ne kuader te kerkesave te ketyre neneve ,askund nuk thuhet se aji i cili nuk ka ushtru kerkese per rishqyrtim apo ankese ne fazen e pare eshte pale e painteresuar.Kjo bie ndesh me vendimin e OSHP dhe AK**.
Neni 59 Rregullorja nr.001/2022 per PP:Citoje:Dispozitat e përgjithshme
Pika 59.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.Prfundim citati:
**OSHP-ja ka bere shkelje sepse ka kufizuar fazat e ushtrimit te ankesave e kjo bie ndesh me nenin e cituar me larte.**
Neni 4 pika 3.e LPP citoje:Përveç kur konteksti në mënyrë të qartë kërkon një kuptim tjetër, termet dhe përkufizimet në nenin 4 të këtij ligji do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me interpretimin dhe zbatimin e termeve të ngjashme ose të njëjta të cilat janë përdorur në Direktivat e KE-së.Perfundim citati.
Lexoni direktivat e BE dhe binduni se askund nuk ceket se OE i cili ne nji faze nuk ka ushtru kerkese per rishqyrtim dhe ankese ne OSHP nuk eshte pale e interesit.**Nuk ka interferu as OSHP e as AK per ta kuptuar drejte kete nene.**
Neni 4 pika 6 e LPP citoje: Përveç nëse konteksti qartësisht kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj ligjeve, rregulloreve ose akteve të tjera nënligjore ose cilësdo dispozitë të caktuar të tyre duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me akte të reja që rregullojnë fushën e njëjtë, referencat në këtë

ligj duhet të interpretohen për t'i përfshirë këto akte të reja dhe, sipas rastit, dispozitat gjegjëse në to.Perfundim citati.
Nuk ka interferu as AK e as OSHP-ja per te kerkuar interpretim apo ndryshim te nenit e me ja shtu testin se OE i cili ne nji faze nuk ka ushtru kerkese per rishqyrtim dhe ankese ne OSHP nuk eshte pale e interesit.,njikohesisht me i njoftu AK dhe OE per plotesimin apo ndryshimine ketij neni,e jo me vepru pa asnji interpretim apo njoftim paraprak.
Neni 67 i Rregullorja nr.001/2022 per PP:CitojeNjë vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar. Perfundim citati.
**AK nuk ka reflektuar vetum e ka zbatuar vendimin e OSHPP**.
Neni 117 i LPP: Citoje:Afati i fundit për marrjen e vendimeve
Pika 1.OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij.Perfundim citati:
**OSHP-ja ka nxjerre vendim jashta afateve ligjore(llogaritni ditet) pa asnji arsyetim per shtyrjen e afateve dhe eshte i pavlefshum ,nji vendim i till duhet terhjekur nga ana e OSHP-se**.
**Mendimi yne**:Vet termi ri-vlersim kupton rivlersimin e ofertave ne tansi e jo selektive. Se OE ND sh.p.k në heshtje ka pranuar eliminimin kjo nuk qëndron pasi qe ky
Aktivitet ka qene në proces dhe nuk ka pasë ndonjë ndërprerje të procedurës.
Mendojm se eshte vepruar ne kundershtim me LPP ,RRPP 001/2022,RRP se OSHP 01/2020,dhe eshte pruar vendim jo i drejte si nga OSHP-ja me nr.603/23 e poashtu edhe i AK i dates 21.12.23. Per detaje edhe me te shumta gjeni te bashkangjitur njoftimin e dates 21.11.23 drejtuar te kryetarja e OSHP z,Vjosa Gradinaj Mexhuani per mbrojtejen e ligjeshmeris .
Per sa kohe eshte funksionalizuar LPP e deri me tani asnjiher nuk eshte vepruar me LPP nenin 4 pika 1.26 kesisoji.Mendojm se punonjesit e OSHP ndrrohen por ligji eshte i njejti ,eshte e jashteligjeshme te i u epet dykuptimesi neneve te LPP,egziston rruge lligjore per veprime te tilla,nese fillohet te veprohet keshtu do futemi ne abuzime me ligjin(qka nese OE ankues ta kishte oferten me qmim te buxhetuar 103,200.00 euro, sipas keti veprimi duhet dhene kontraten me kete qmim e keshtu po u mbrojka shfrytezimi i paras publike).Per te vepruar keshtu si ka vepruar OSHP e pastaj AK duhet draftuar LPP nenin 4 pika 1.26,nenin 117 pika 1,Neni 109 pika 1,Neni 98 pika 1 dhe 3,neni 103 pika 1,nenei 104 pika 2 dhe 3 dhe Rregulloren e punes se OSHP nr.01/2020 nenin 2 pika 1.2. dhe paraprakisht te njoftohen AK dhe OE e pastaj te aplikohet.Mendoj se ligji duhet respektuar njisoj si nga OSHP,AK dhe OE e jo te sankcionohen vetum OE ndersa AK e OSHP-ja ti anashkalojn shkeljet si edhe kan vepruar ne rastin konkret qdoher sipas opinionit tone.
**Perfundim:Propozojm qe OSHP ta ktheje lenden ne rivlersim ta mbaje ne fuqi vendimin AK te dates 04.08 23 mbi dhenjen e kontrates OE ND shpk,sepse oferta jone dhe veprimet tona jane konform DT LPP,RRPP dhe RRPOSHP ne te kunderten per ne eshte diskriminim i paster dhe favorizim i te tjereve .**

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Shpenzimet rreth pregaditesje se ofertes,ankesave,fitimit te humbur,sigurimeve. Te prodhuesit po dalim jo serioz si kontraktor dhe jemi duke i humbur partneret afarist.**

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin mbi Vendimin e AK "*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *një kopje të raportit te vleresimit të tenderëve*
f) *një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se- Kerkesa per rishqyrtim per A.K. dhe Pergjigja ne kerkesen per rishqyrtim*
g) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
h) *të gjitha dokumentet me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Sligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **KEK-23-1746-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **KEKC-23-070-121** |

Sa i përket tenderit për

**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

**1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

**ND shpk**

_____

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Zona e Re 1 Vetenik*_____

*(Adresa)*

*Prishtine*_____*10000*

*(Vendi)* *(Kodi postar)*

*_044124661*_____ _____

*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

*Avni Musliu*_____

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*__ndshpk@yahoo.com*_____

*(Adresa elektronike)*

*26.12.23*_____ _____

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

____*NA*_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| *07.03.23 Njoftimi per kontrate,*<br>*21.12..23 Leter standarde per tenderuesin e papergjegjeshum*<br>*21.12.23 Njoftim mbi vendimin e AK* |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| E prokurim |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [+] **Jo** [ ]

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**LPP:Neni 1;Neni 4.Pika 1.26:pika 3 dhe pika 6;neni 117 pika 1;neni 98 pika 1 dhe 3; neni 109 pika 1;neni 104 pika 2 dhe 3;neni 59 pika 2 dhe 4; neni 28; neni 72,**
**DT neni 3. 7**
**Rregullorja nr.01/2022 per PP neni 40;Neni 59 pika 1;neni 67 pika 7**
**Rregullorja 01-2020 e punes se OSHPP:Neni 2 pika 1.2**

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**E kundershtojm vendimin e AK per anulim te tenderit dhe eliminimin si i papergjegjeshum.**
**Arsyetimet tona jane :**
Neni 4 pika 1.26 e LPP citoje: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar Perfundim citati.
***Deshmi se jam pale e interesuar qe deshmon interes material me deshmi materiale eshte polisa e sigurimit valide per oferten tone valide***.
Neni 2 pika 1.2 e Rregulloreja nr 001/2020 e punes se OSHP citoje: Pale-eshte qdo person i cili ne lendet e trajtuara nga OSHP,paraqitet ne cilesi te autoriteti kontraktues,ofertuesit,personit te interesuar,perfaqesuesit ligjor apo i autorizuar i tyre .Perfundim citati.
**Ne jemi ne kuader te kerkesave te keti neni ,askund nuk thuhet se aji i cili nuk ka ushtru kerkese per rishqyrtim apo ankese ne fazen e pare eshte pale e painteresuar.Kjo bie ndesh me vendimin e OSHP dhe AK.**
Neni 59 Rregullorja nr.001/2022 per PP:Citoje**:**Dispozitat e përgjithshme

Pika 59.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që pretendohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.Prfundim citati:

**OSHP-ja k bere shkelje sepse ka kufizuar fazat e ushtrimit te ankesave e kjo bie ndesh me nenin e cituar me larte.**

Neni 4 pika 3.e LPP citoje:Përveç kur konteksti në mënyrë të qartë kërkon një kuptim tjetër, termet dhe përkufizimet në nenin 4 të këtij ligji do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me interpretimin dhe zbatimin e termeve të ngjashme ose të njëjta të cilat janë përdorur në Direktivat e KE-së.Perfundim citati.

**Lexoni direktivat e BE dhe binduni se askund nuk ceket se OE i cili ne nji faze nuk ka udhtru kerkese per rishqyrtim dhe ankese ne OSHP nuk eshte pale e interesit.Nuk ka interferu as OSHP e as AK.**

Neni 4 pika 6 e LPP citoje: Përveç nëse konteksti qartësisht kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj ligjeve, rregulloreve ose akteve të tjera nënligjore ose cilësdo dispozitë të caktuar të tyre duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me akte të reja që rregullojnë fushën e njëjtë, referencat në këtë ligj duhet të interpretohen për t'i përfshirë këto akte të reja dhe, sipas rastit, dispozitat gjegjëse në to.Perfundim citati.

**Nuk ka interferu as AK e as OSHP-ja**

Neni 67 i Rregullorja nr.001/2022 per PP:Citoje**:**Vendimi i OSHP 67.7 Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar. Perfundim citati**.**

**AK nuk ka reflektuar**

Neni 117 i LPP: Citoje:Afati i fundit për marrjen e vendimeve

Pika 1.OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij.Perfundim citati:

**OSHP-ja ka nxjerre vendim jashta afateve ligjore(llogaritni ditet) dhe eshte i pavlefshum si i tille duhet injoruar nga AK.**

Mendimi yne:Vet termi ri-vlersim kupton rivlersimin e ofertave ne tansi e jo injoruar disa. Se OE ND sh.p.k në heshtje ka pranuar eliminimin kjo nuk qëndron pasi qe ky
Aktivitet ka qene në proces dhe nuk ka pasë ndonjë ndërprerje të procedurës.
Mendojm se eshte vepruar ne kundershtim me LPP ,RRPP 001/2022,RRP se OSHP

01/2020,dhe eshte pruar vendim jo i drejte si nga OSHP-ja poashtu edhe AK.
Per sa kohe eshte funsionalizuar LPP e deri me tani asnjiher nuk eshte vepruar me LPP nenin 4 pika 1.26 kesisoji.Mendojm se punonjesit e OSHP ndrrohen por ligji eshte i njejti,nese fillohet te veprohet keshtu do futemi ne abuzime te ligjit(qka nese OE ankues ta kishte oferten me qmim te buxhetuar 103,200.00 euro, sipas keti veprimi duhet dhene kontraten me kete qmim e keshtu po u mbrojka shfrytezimi i paras publike).Per te vepruar keshtu si ka vepruar OSHP e pastaj AK duhet draftuar LPP nenin 4 pika 1.26,nenin 117 pika 1,Neni 109 pika 1,Neni 98 pika 1 dhe 3,neni 103 pika 1,nenei 104 pika 2 dhe 3 dhe Rregulloren e punes se OSHP nr.01/2020 nenin 2 pika 1.2.Mendoj se ligji duhet respektuar njisoj si nga OSHP,AK dhe OE e jo te sankconohen vetum OE ndersa AK e OSHP-ja ti anashkalojn shkeljet si edhe kan vepruar ne rastin konkret.Ju si AK tani jeni tu tregu jo seriozitet sepse per te njejten lende jepni shum mendime,her jemi te pergjegjeshum e her jo.Vendimet e OSHP i zbatoni pjeserisht nese i analizoni me ne detale sepse ajo dy her e ka kthy lenden ne rivlersim.
**Perfundim:Propozojm qe AK ta ktheje lenden ne rishqyrtim ta mbaj ne fuqi vendimin e dates 04.08 23 mbi dhenjen e kontrates OE ND shpk,sepse ne konform DT kemi ofertuar me te gjitha kerkesat e AK.**

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Shpenzimet rreth pregaditesje se ofertes,ankesave,fitimit te humbur,sigurimeve. Te prodhuesit po dalim jo serioz si kontraktor dhe jemi duke i humbur partneret afarist.**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin mbi vendimin e AK".*
c) *një kopje të letrës se tenderuesit të papergjegjeshum.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

# NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

**Numri i aktivitetit te prokurimit: KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)**

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës |
|---|---|---|
| 1. | ND SH.P.K. | 61,360.00 € |
| 2. | " UNIVERS-M " SH.P.K. | 66,080.00 € |
| 3. | NOVAMAT sh.p.k | 93,267.20 € |
| 4. | RH SH.P.K. | 103,840.00 € |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. anulon** aktivitetin e prokurimit në mungese të ofertave te përgjegjshme.

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit
KEK – sh.a.

20.12.2023

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

# Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [1]

**ND shpk Veternik, Zona e Re, 10000 Prishtinë**

| | |
|---|---|
| **Nr. i prokurimit:** | **KEK-23-1746-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **KEKO-23-070-121** |

**Titulli: Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

I nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshme:

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 59 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye:

- Sipas Vendimit të OSHP-së me nr. 2023/0603 oferta e juaj është me status të palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP-së, pra oferta e juaj është e papërgjegjshme.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit; KEK-sh.a.

20.12.2023

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.*

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ ***PUNË*** ☒ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 07.03.2023**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **KEK-23-1746-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.** | | |
| **Adresa Postare**: **Rr. Nënë Tereza, 36** | | |
| Qyteti: **Prishtinë** | Kodi postar: **10 000** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Ymer Dragusha** | Telefoni: **038/501401 1184** | |
| Email: **ymer.dragusha@kek-energy.com** | Faksi: | |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: **www.kek-energy.com** | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☐ **Punë** | ☒ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☒ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Depo TCA,Obiliq**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

29836430-1

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 103,200.00**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Sasia valva te avullit me kontra flanxha për fryesat e blozes në kazanin e bl. l ( A3,A4,A5 ),8 copë**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë **60** (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **50** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| ***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| | |
|---|---|
| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**<br><br>**1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit. 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – kopje e noterizuar .-kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**1.Një deklarata nën Betim,e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise,pika 2 dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën.Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës.Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.** |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**<br><br>**1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3.Regjistrimi i numrit fiskal** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2.Kopja e certifikatës TVSH-se; 3.Kopja e certifikatës numrit fiscal** |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**<br><br>**1.Certifikatat e produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet 2.Katalogë apo prezantime grafike (vizatimet ) dhe ose fotografi të produkteve për furnizim,bashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt qe ofertoni** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**1. Çertifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015) me të cilën dëshmohet se prodhuesi prodhon enët nën presion 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike të vulosura nga prodhuesi i valvave dhe të gjitha pjesëve të valvave , me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.** |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☐

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

**Po** ☐ **Jo** ☐

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

| IV.1.1) Lloji i procedurës |
|---|
| ☒ **E hapur** |
| ☐ **E kufizuar** |
| ☐ **Konkurruese me negociata** |
| ☐ **Kuotim i Çmimit** |
| **IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*<br><br>Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë: |
| **IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*<br><br>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme<br>**Po** ☐ **Jo** ☐<br>në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar<br><br>Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë<br>kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata<br>**Po** ☐ **Jo** ☐ |
| **IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**: |
| **IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**<br><br>Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒<br><br>Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik: |

### IV.2) KRITERET E DHËNIES

| |
|---|
| ☒ **Çmimi më i ulët**<br>*ose*<br>☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të** |
| |

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***
Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*
i
i

**Po** ☐ **Jo** ☒
Dokumentet me pages

***Nëse po,*** çmimi EUR
Kushtet dhe metoda e pagesës:

**IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***

***data*** **29.03.2023** ***koha*** **12:00:00** ***vendi*** **Dorezimi i ofertave - Vetëm përmes platformës eprokurimit**

**IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**
☐ **Po** ☒ **Jo**

***Nëse po,*** jep arsyetim

**IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:
**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **3,000.00**
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **90** *apo* muaj

**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**
Deri më: data: ditët **60** apo muajt

**IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**

**data 29.03.2023 koha 12:00:00 vendi KEK- Zyra Ekzekutive e Prokurimit Sheshi Nena Terezë,nr.36,Prishtinë**

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

## V.1) ANKESAT

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

## V.2) INFORMACIONET SHTESË

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**
*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*
**Operatorët ekonomik me ofertë duhet të dorëzojnë një Deklaratë të Vendit të Origjinës së Prodhimit të mallërave (ose nëse mallrat e ofruara mund te prodhohen nga me shume vende, te deklarohet në ofertë të gjitha ato vende)**

KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

# Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

**Nga:** Korporata Energjetike e Kosoves sh.a.

**Për: ND shpk– Prishtinë**

| | |
|---|---|
| **Nr. i Prokurimit[2]** | KEK-23-1746-1-2-1 |
| **Nr i brendshëm** | KEKO-23-070-121 |

**Titulli: Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozëz ne kazanin e bl.A3,A4,A5**

Të nderuar ,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.
Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin me çmimin më të ulët* si përgjigje ndaj *njoftimit të prokurimit publik* për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj:61,360.00 €(me TVSH),në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*
Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i është bashkangjitur kësaj letre.

Me respekt,

***Zyra Ekzekutive e Prokurimit***

04/08/2023

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*
[2] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
04-01-2024
Nr. 45
PRISHTINË - A

Data 04.01.2024

| | |
|---|---|
| PËR OPERATORIN EKONOMIK | **ND shpk** |
| NGA | KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS<br>Zyra Ekzekutive e Prokurimit, rr. Nëna Terezë nr. 36<br>10000 Prishtinë.<br>Driton Bytyqi, u. d. Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit |
| NUMRI I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM | PERMES PLATFORMËS E PROKURIMI |
| DATA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS | 26.12.2023 |
| SHQYTIMI I ANKESËS TË PARASHTRUAR | ☒ **Eliminimi pas vlerësimit të tenderit** |
| TITULLI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT | **Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5** |
| Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT | **KEK-23-1746-1-2-1** |
| Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT I BRENDSHEM | **KEKO-23-070-121** |
| DATA E NJOFTIMIT PËR KONTRATË | 07.03.2023 |
| DATA E PRANIMIT TË TENDERËVE | 29.03.2023 |

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik **ND shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**" me nr. prokurimit **KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)**, Autoriteti Kontraktues mori këtë:

## Vendim

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik **ND shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**" me nr. prokurimit **KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)**.

## Arsyetim

Me datën 26.12.2023, Autoriteti Kontrakrues KEK.sha ka pranuar kërkesën për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik **ND shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**" me nr. prokurimit **KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)**.

Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit të ofertave, Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni profesional vlerësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:

ANALIZA DHE SQARIMI I NJËSIS KËRKUESE

Sqarim:

- Ne kërkesën për rishqyrtim keni kërkuar rishqyrtimin e ofertës tuaj me arsyetim se A.K. ka bërë zbatim jo të drejtë të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042 dhe Rregulloreve ne fuqi.
- Pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të prezantuara, analizimit të dispozitave në fjalë, komisioni vlerësues e kundërshton kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar:

**Arsyetim:**

- Pretendimi se nuk është zbatuar LPP-ja dhe rregulloret ne fuqi nuk qendron, gjate vlerësimit te ofertës tuaj nuk është bërë asnjë diskriminim.
- Ne si AK po ju kthejme pergjigje per çeshtjet per te cilat kemi pergjegjesi dhe jemi kompetent, ndersa per çeshtjet per te cilat nuk jemi kompetent ju mund te procedoni me tutje ne organet kompetente.
- Ne Kërkesë për rishqyrtim keni pretenduar se ju si Operatore Ekonomik jeni pale me interes. Ne si Autoritet Kontraktues gjatë vlerësimit kemi vepruar konform Vendimit të OSHP-së me nr. 2023/0603 ku oferta e juaj është me status të palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP-së.

REKOMANDIMI I NJËSISË KËRKUESE SI DHE ZYRËS EKZEKUTIVE TË PROKURIMIT

- Komisioni profesional vlerësues bazuar në sqarimet e dhëna më lart për aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**" me nr. prokurimit **KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)** pretendimet e Operatorit Ekonomik **ND shpk** i vlerson si të pabazuar.
- Komisioni profesional vlerësues rekomandon që kërkesa për rishqyrtim e Operatori Ekonomik **ND shpk** të refuzohet.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ankesën e Operatorit Ekonomik **ND shpk** i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimin e komisionit profesional vlerësues për aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5**" me nr. prokurimit **KEK-23-1746-1-2-1 (KEKO-23-070-121)** ka vlerësuar se Operatori ekonomik ne ankesën e tij nuk ka prezantuar prova me të cilën e vërteton faktin se vendimi i marr nga autoriteti kontraktues nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në LPP, andaj si i tillë nuk paraqet bazë të mjaftueshme për ndryshimin e vendimit te marre me date 20.12.2023.
Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marr parasysh dëshmitë e dërguara nga Operatori ekonomik si dhe rekomandimet nga komisioni ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së konform dispozitave ligjore te LPP-se nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet :

1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik
1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit të Prokurimit
1x1 ekzemplar – Arkivës së KEK-ut

u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit

04.01.2024

Driton Bytyqi

**Nga: ND SH.P.K. me drejtorin Avni Musliu** (palë e interesuar)

**Për : Vjosa Gradinaj-Mexhuani - Kryetare e Organit Shqyrtues të Prokurimit**

**N J O F T I M**
Lidhur me Vendimin OSHP:2023/0603

Duke u bazuar në nenin 102, nenit 4 pargarfi 1.26 dhe 3 të LPP, dhe Regulloressë Punës se OSHP-se nr.01/2020 neni 2 pika1.2 ne OE ND shpk si person i interesuar i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, me këtë parashtresë ju Njoftojmë dhe paraqesim shqetësimet tona, si në vijim:

*Kronologjia*

Me dt.07.03.2023 KEK si AK kishte publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me valvula të avullit me kontra fllanxha për fryerësat e blozës në kazanin e bl.A3, A4,A5. Me dt.04.08.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në të cilin është paraqitur se OE ND shpk Prishtinë, është shpërblyer me kontratën, me vlerën totale të ofertës 61,360 euro.
Me dt.09.08.23 OE Univers ka paraqitur Kërkesen për rishqyrtim, kurse AK kishte Refuzuar kërkesën për rishqyrtim.
Me dt.22.08.2023 OSHP ka pranuar ankesën nga OE "UNIVERS-M" SHPK lidhur me Vendimin për shpërblim me kontratë të lartëcekur. Kishte paraqitur ankesat kinse OE që kishte fituar tenderin (me çmimin më të ulët) nuk paska plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ate duke pretenduar se: Një zyrtar ishte caktuar dy herë në komisionet e vlerësimit- Se AK nuk paska dhënë qasje në katalog, Se- ISO çertifikata qenka konsideruar dokument sekret dhe se OE ND shpk nuk paska plotësuar specifikimin teknik të detyrueshme-aneksin1, për mallrat e ofruara. Të gjitha këto pretendime i kishte hudhur poshtë dhe i kishte argumentuar bindshëm shumë kjartë dhe në favor të OE ND shpk eksperti shqyrtues në raportin 2023/0603 bashkangjitur çështjes juridike dhe kishte propozuar që të mbetet në fuqi Vendimi i AK në favor të OE ND shpk.
Eksperti shqyrtues ka paraqitur se janë plotësuar kriteret e dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
ND shpk ka të realizuar validitetin e tenderit (neni 30 LPP)

OSHP me Vendimin 2023/0603 të dt.13.11.2023 ka Aprovuar pjesërisht ankesën e Univers-M shpk, ka Anuluar vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit të KEK kurse këtë aktivitet e ka kthyer në ri-vlerësim.

*Pretendimet ankimore të OE ND shpk*

E nderuara Kryetare e OSHP-se, shqetësimi i OE ND Shpk qëndron në faktin se arsyetimi i këtij vendimi nuk është real, nuk është i drejtë, është i paargumentuar mjaftueshëm dhe ky arsyetim ka tejkaluar kompetencat e vet panelit shqyrtues. Kjo nga këto arsye:
Se ky akt administrativ (Vendimi OSHP:2023/-603) pa të drejtë dhe në mënyrë të paargumentuar mjaftueshëm ka prekur edhe persona tjerë OE përveq atyre që kanë qenë palë në procedurë.

Në realitet ky Vendim kishte konstatuar se çfarë hapash proceduralë duhet të ndërmarrë autoriteti kontraktues duke paraqitur këto fjali: *"OE i rekomanduar për kontratë ND shpk, për këtë aktivitet të prokurimit është I papërgjegjshëm dhe përmes këtij vendimi eliminohet nga pjesëmarrja në të".*

Dhe, shtrohet pyetja me çfarë të drejte në këtë Vendim janë dhënë konstatimet të cilat prekin personat e tretë gjegjësisht pranueshmërinë e kandidatëve ose tenderuesve?

Kjo, sepse Neni 65 të Ligjit për prokurimin publik Nr. 04/L-042 (pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve) dhe Ligjin 05/L-068 tregon kriteret kur një OE mund të konsiderohet I pranueshëm dhe të gjitha paragrafet e këtij neni në vazhdim decidivisht tregohet se pa ndonjë aktgjykim përfundimtarë nuk mund të zbatohen dispozitat për pranueshmërinë e kandidatëve ose tenderuesve.
*Prandaj, ligjërisht në rastin konkret OE nuk mund të përjashtohet, të eliminohet dhe të deklarohet I papërgjegjëshëm në këtë procedurë të tenderit me nr.prokurimit KEK-23-1746-1-2-1, ashtu siq është deklaruar në arsyetimin e Vendimit kontestues.*

Gjithashtu Neni 105 (Kompentencat e OSHPsë) të LPP-së nuk ka paraparë askund që OSHP-së t'i jap kompetenca që e njejta të shpallë ndonjë opetator ekonomik të papërgjegjshëm, hiç më pak në rastet kur operatori nuk është palë në proces.

Kurse, te procesi i ri-vlerësimit në procedurat e udhëhequra te AK, duhet të ju rikujtojmë se "Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar".(shiqo nenin 64 ligjit bazik 116 pas paragraf.5).

Për këtë arsye, autoriteti administrativ duhet të informojë palën (edhe ate të interesuar), për të qartësuar ose korigjuar gabimet në kërkesën e saj, kur nuk është paraqitur sipas ligjit, *për aq sa është e nevojshme*, rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre në përputhje me procedurën administrative. Dhe, mos respektimi i këtij parimi procedural në fazën paraprake gjithsesi sjellë përgjegjësinë e organit për humbjen që mund t'i shkaktohet këtij personi.
Nga të cekurat më lartë, ne si palë e interesuar tani në këtë situatë Ju lutemi që mundësisht të kërkohet korrigjimi i vendimit bazuar në nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, decidivisht pjesa arsyetuese dhe të largohet konstatimi i papërgjegjshmërisë konform argumenteve si më lartë. Apo që eventualisht Kryetarja e OSHP-së mund të veproj vet, është të e suspendoj efektin pezullues të ankesës në OSHP.

Me respekt,
OE ND SHPK Prishtinë
Avni Musliu

21.11.23

SHOQËRIMI PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ND Sh.p.k. PRISHTINË